



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS **KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA**

Procesverbal i mbajtur më 25 shtator 2024, në mbledhjen e XXVIII-të (njëzetetë) mandati VII-të i Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit në ndërtesën e re të Komunës, dhe filloi në orën 10:10.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, përkatësisht i këtij Komiteti.

Fillimisht u konstatua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti, dhe atë; (Naim Çunaku; Arnisa Sylejmani; Haki Rudari; Drita Pajaziti; Sebastina Vokrri; Bashkim Sylja; Mrika Thaçi dhe Qëndrim Softolli) bashkëngjitur lista e nënshkrimeve.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje e pranishme ishin edhe; z.Shuajb Blakçori drejtor i Drejtorisë së Administratës-DA; znj.Adelinë Stublla drejtoresh e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale-DSHMS; z.Fatlum Osmani drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF; Vlora Humolli Jashanica drejtoreshë e Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit-DKRS.

Rendi i ditës

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, e hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit, konstatoi kuorumin, ndër të tjera theksoi, sa i përket materialit dhe thirrjes së kësaj mbledhje besoj se të gjithë jeni pajisur me materialin, andaj pa humbur kohë e vë në votim rendin e ditës, nëse nuk ka kërkuar fjalën ndokush.

Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se njëzëri nga 9 anëtarët e Komitetit miratohet rendi i propozuar i ditës sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

1. Propozim vendim për miratimin e projektbuxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2025 dhe parashikimet buxhetore 2026-2027.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, sot e kemi një pikë mjaftë të rëndësishme dhe nuk kemi nevojë të debatojmë jashtë rendit të ditës, të gjithë e dini se propozim vendimi i buxheti është një dokument mjaftë i rëndësishëm për kuvendin komunal, dihet se kemi një rritje të buxhetit ku vlera e buxhetit është 33,451,115.00€, besoj se është një buxhet i kënaqshëm, ndoshta sqarimet e duhura na i jep z.Fatlum Osmani drejtori i DBF-së.

z.Fatlum Osmani, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF, e paraqiti fjalën hyrëse rreth këtij propozim vendimi, theksoi, buxheti i Komunës së Podujevës pa dyshim është dokumenti më i rëndësishëm që e miraton brenda vitit asambleja komunale dhe që propozohet nga ana e Ekzekutivit. Buxheti për vitin 2025 në bazë të Qarkores Buxhetore të lëshuar nga Ministria e Financave është

33,459,115.00€, normalisht Qarkorja Buxhetore përcakton edhe kategoritë tek të cilat duhet të ndahet ky buxhet ku përfshihen kategoria e pagave, e mallrave, komunalit, subvencione dhe kategoria e kapitaleve. Normalisht që këtyre limiteve buxhetore duhet t'iu përmbahemi qoftë ne si Ekzekutiv në planifikim ashtu edhe ju si Kuvend në miratim sepse nuk mund të dalim përtej këtyre limiteve të përcaktuara nga ana e Ministrisë së Financave në Qarkoren Buxhetore.

Materialin e keni marrë me kohë dhe ju ftoj që këtë propozim ta mbështetni për diskutim dhe miratim në seancën e asamblesë komunale.

z.Haki Rudari, theksoi, natyrisht se projektbuxheti është një dokument i rëndësishëm përmes të cilit parashihen edhe investimet në Komunën tonë për të gjithë sektorët, ne kemi një buxhet ashtu siç u tha ndoshta më i larti deri më tani dhe në këtë buxhet përveç shumë tjerash kemi shpenzime kapitale 9,256,442.00€, do të thotë për 10,000.00€ kemi rritje të kapitaleve që mendoj se janë në interes të qytetarëve për arsye se këto investime bëhen nëpër sektor siç janë shëndetësia, arsimiti, infrastruktura, bujqësia e të tjera, andaj ne Grup i LVV-së e përkrahim këtë pikë të rendit të ditës dhe natyrisht se votën tonë do ta keni për, edhe nesër në seancën e Kuvendit.

z.Naim Çunaku, theksoi, pa dashur të flasë për rëndësinë e një projektbuxheti duke pas parasysh se ky projektbuxhet i ka të përcaktuara fazat ku dihet edhe kur përfundojnë afatet kohore deri më 30 shtator dhe sigurisht ne Grupi i LDK-së e përkrahim që të kalon për shqyrtim në Kuvend.

Nga ajo që dëgjova nga parafolësi - shefi i Grupit të këshilltarëve të LVV-së se është buxheti më i madh deri më tani, i them kolegut se është e vërtetë se prej vitit 2000 deri sot që jemi në vitin 2024 vazhdimisht buxheti është në ngritje sepse fundja ato janë taksat e qytetarëve që për çdo vit shtohen dhe arrijnë deri në një shifër të cilën e përmendi z.Haki Rudari.

Më gëzon fakti që një prej pjesës së konturave të buxhetit që përfshin investimet kapitale ka arrit mbi 9,000,000.00€, mirëpo të kemi parasysh edhe koston e projekteve që sot mund të realizohen me ato 9,000,000.00€, dhe koston e projektit që ke mund ta realizosh, shembull me 5,000,000.00€ e që aty për aty kemi vlerësimin e fuqisë blerëse, gjegjësisht fuqisë së realizimit të projekteve. Si do që të jetë për mua diçka që e kam potencuar që tri vite radhazi është se nuk jam i kënaqur me formën qysh kemi arritur te buxheti, e kemi thënë edhe herëve tjera dhe nuk kam si ta kaloj pa i cek afatet kohore dhe dëgjimet buxhetore kur kemi Udhëzimet Administrative dhe dihen afatet kohore. Në një formë Kuvendi i Komunës nuk e ka në rolin e tij sa i përket hartimit të buxhetit dhe këtë e kemi potencuar disa herë dhe nuk kaloj pa e potencuar sërish se projektbuxheti ka dashur të jetë në dorën e kuvendarëve më datë 1 shtator 2024, kurse pas kësaj periudhe deri më datë 13 shtator ka pas dëgjime publike me qytetar nga Ekzekutivi, do të thotë na është ngushtuar hapësira dhe nuk na është dorëzuar buxheti më 1 shtator 2024, dhe si rezultat i kësaj Kuvendi ka mbet në një formë zbatues i ligjit të hartimit të buxhetit sepse të paktën zotëri Kryesues e kam bindjen që ti e din që Kuvendi i Komunës e ka pas obligim ligjor që ta organizon debat me qytetar dhe kemi thënë disa herë që Kuvendi është pronari i buxhetit ndërsa shpenzuesi është Ekzekutivi, por si do që të jetë për specifika tjera do të flasim në seancën e Kuvendit.

Do të më gëzonte fakti të paktën që për një periudhë të gjatë ta kemi buxhetin e përgatitur sepse ligji dhe Udhëzimi Administrativ për Standardet Minimale të Hartimit të Akteve Komunale e parasheh këtë dhe ne tani jemi ndesh me të dyja këto, duke shkuar në këtë formë por fundja përgjegjësia është mbi akterët që kanë vepruar kështu. Ne Grupi i LDK-së kemi votën për, që të kaloj për nesër në Kuvend kjo pikë e rendit të ditës, kur specifikisht vërejtjet dhe sugjerimet do t'i bëjmë nesër në Kuvend.

z.Bashkim Sylja, theksoi, nga ajo që u tha prej parafolësve se afati i fundit për miratimin e buxhetit është data 30 shtator 2024, kështu që ne në seancën e nesërme do t'i japim propozimet dhe vërejtjet tona dhe e përkrahim këtë pikë të rendit të ditës.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, ndër të tjera theksoi, nëse dikush nga ju dëshiron ta marrë fjalën urdhëroni, nëse jo atëherë e vë në votim propozim vendimin për miratimin e projektbuxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2025 dhe parashikimet buxhetore 2026-2027, që t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim.

Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se nga 9 anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, njëzëri me 9 vota Për, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim propozim vendimi për miratimin e projektbuxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2025 dhe parashikimet buxhetore 2026-2027, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhjes.

Meqë nuk pati të lajmëruar për të marrë fjalën, Kryesues i Komitetit e konstaton të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në orën 10:20

**Procesverbalin e mbajti;
Osman Bajrami**

**Nr.Prot.01-060/04-0064705/24
Podujevë,
25 shtator 2024**

**Kryesuesi i Kuvendit - Komitetit
Hilmi Hoxha**